



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

I nderuar Z. Kryetar i Komisionit,

Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë, anëtarë të Komisionit,

Fillimisht, dua t'ju falënderoj për mundësinë për të prezantuar Raportin Vjetor të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2022, si edhe për të ndarë me ju disa nga zhvillimet kryesore të tregjeve nën mbikëqyrje gjatë vitit të kaluar dhe muajve të parë të këtij viti.

Viti 2022 ka pasur zhvillime të rëndësishme në tregjet financiare jobankare, si edhe në procesin e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit u shfaqën të qëndrueshëm sa i përket treguesve kryesorë të shëndetit financiar, marrë në konsideratë efektet e faktorëve të brendshëm e të jashtëm. Autoriteti monitoroi në mënyrë të kujdesshme ecurinë e këtyre tregjeve, duke ndërhyrë përmes masave në funksion të mbrojtjes së investitorëve dhe personave të siguruar, si edhe të ruajtjes së shëndetshmërisë financiare.

Viti 2022 ishte një vit i rëndësishëm për Autoritetin sa i përket avancimit ligjor e rregullator në drejtim të përafrimit me direktivat dhe acquis të BE, hapjes zyrtare të negociatave dhe kryesimit të Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”. Autoriteti udhëhoqi grupin negociator për këtë kapitull gjatë takimeve në Bruksel, fillimisht me procesin screening për bazën ligjore e rregullatore, pasuar nga takimi bilateral i mbajtur në shkurt 2023. Ekspertët e Komisionit Evropian vlerësuan progresin e bërë dhe angazhimet e marra në Kapitullin 9 për plotësimin e rekomandimeve dhe vijimin e procesit të përafrimit ligjor në fushën e shërbimeve financiare.

Autoriteti plotësoi më tej bazën rregullatore, në zbatim të ligjeve të reja në tregjet nën mbikëqyrje, të përafruara me direktivat evropiane. Gjithashtu, përfundoi

hartimin e projektligjit “Për fondet e pensionit privat”, duke realizuar një përafrim në masë të gjerë me Direktivën e BE për pensionet profesionale.

Në një tjetër zhvillim për t’u veçuar gjatë vitit 2022, Autoriteti shënoi avancim domethënës në vlerësimin e bërë nga Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve në Sigurime (IAIS) mbi përputhshmërinë me standardet ndërkombëtare. AMF iu nënshtrua gjatë vitit të kaluar një procesi rigoroz vlerësimi nga një grup ekspertësh ndërkombëtarë të IAIS, që përfshiu aspektin ligjor e rregullator, pavarësinë institucionale, procedurat e licencimit, praktikat mbikëqyrëse dhe ato të vlerësimit të rrezikut, etj.

Në draftraportin e Grupit të Vlerësimit të IAIS-it, rezultoi përgjithësisht një nivel i lartë i përputhshmërisë me ICP-të (Parimet Themelore në Sigurime). Sipas përlllogaritjeve, mesatarja e ponderuar e përputhshmërisë së ICP-ve është rritur në 77.9%, krahasuar me 47.4% që ishte në vlerësimin e fundit, realizuar nga Banka Botërore dhe Fondi Monetar Ndërkombëtar në vitin 2014 në kuadër të Programit të Vlerësimit të Sektorit Financiar (FSAP).

Raporti përfundimtar i vlerësimit të përputhshmërisë me parimet bazë ndërkombëtare në sigurime, do të miratohet nga Komiteti Ekzekutiv i IAIS-it gjatë vitit 2023 dhe në linjë me rekomandimet e raportit, Autoriteti do të vijojë punën në drejtim të rishikimit të kuadrit ligjor e rregullator në fushën e sigurimeve, me synim përafrimin e mëtejshëm me Parimet Themelore në Sigurime.

Synohet ndër të tjera implementimi i udhërrëfyesit për zbatimin e regjimit mbikëqyrës evropian në sigurime, Solvency II, i hartuar me asistencën e Bankës Botërore, si pjesë e fazës së dytë të projektit 3-vjeçar të asistencës, financuar nga SECO, i cili u përmbyll vitin e kaluar. Zbatimi i këtij regjimi është angazhim i Autoritetit edhe në kuadër të përafrimit të legjislacionit me direktivat e BE-së dhe praktikat më të mira ndërkombëtare në fushën e mbikëqyrjes.

Ky është edhe një nga objektivat e strategjisë 5-vjeçare 2023-2027 të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, që paraqet vizionin e AMF në drejtim të garantimit të stabilitetit financiar, për tregje të qëndrueshme dhe të sigurta, si edhe duke i dhënë prioritet procesit të integritimit në Bashkimin Evropian. Kjo strategji, e cila tashmë është në fazën e implementimit nga ana e AMF, përmes një plani të posaçëm

veprimi, përcakton disa drejtime të rëndësishme për zhvillimin afatmesëm, si forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve, përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve, mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit, financimi i gjelbër, si edhe digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Gjithashtu Autoriteti është angazhuar që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të zbatojë Planin e Veprimit të Dokumentit Politik “Për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”, i miratuar nga Këshilli i Ministrave në muajin prill të këtij viti. Objektiv është promovimi i tregjeve eficiente të kapitalit, nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të këtyre tregjeve dhe mbikëqyrjes efektive të tyre. Dokumenti vendos disa prioritete strategjike, si rritja e pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimi i bazës së investitorit dhe zgjerimi i gamës së instrumenteve financiare, efienca dhe transparenca e tregut të kapitaleve, si edhe zhvillimi i tregut sekondar të Titujve.

Në të njëjtën kohë me miratimin nga Qeveria të këtij dokumenti të rëndësishëm për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, Bordi i Autoriteti miratoi **prospektin e parë të një shoqërie tregtare për emetimin e obligacioneve me ofertë publike në Shqipëri**, në një treg të rregulluar/Bursë. Ky emetim i shton tregut shqiptar të kapitaleve një instrument të ri financiar, duke çuar drejt një game më të gjerë të instrumenteve financiare dhe është një sinjal pozitiv për zhvillimin e mëtejshëm të këtij tregu.

Kjo është hera e parë në tregun vendas të kapitaleve, që titujt e një shoqërie i ofrohen publikut të gjerë, duke shënuar një moment të rëndësishëm për këtë treg si dhe duke shërbyer si shembull për emetime të kësaj natyre edhe nga subjekte të tjera, me qëllim sigurimin e aksesit në kapital përmes ofrimit të alternativave të reja të financimit, përtej atyre të kreditimit nga sektori bankar. Ky lloj emetimi pritet të aktivizojë të gjithë mekanizmat ekzistues të tregut të kapitaleve, siç janë ndërmjetësit financiarë, Bursa dhe Depozitari Qendror i Titujve.

Referuar ecurisë së tregjeve nën mbikëqyrje, edhe në fund të vitit 2022, ato paraqiten të mirëkapitalizuar dhe me tregues të mirë të shëndetshmërisë financiare.

**Në tregun e sigurimeve**, pati një sërë zhvillimesh të rëndësishme pozitive, si më poshtë:

### **Dëmet e paguara në numër në vitin 2022 ishin në nivelin më të lartë historik.**

Numri i kërkesave për dëmshpërblim të paguara nga shoqëritë e sigurimit gjatë vitit të kaluar arriti në 55,705, për një vlerë totale prej 6.25 miliardë lekë. Viti i kaluar shënoi gjithashtu rritje të numrit të dëmeve të paguara për sigurimin e detyrueshëm motorik TPL. Pagesat e larta të dëmeve gjatë vitit 2022, sollën edhe ulje të stokut të dëmeve në status pezull (ende të papaguara). Në fund të vitit të kaluar, dëmet pezull të shoqërive të sigurimit ishin vetëm 13.4% e gjithë dëmeve të trajtuara nga ana e tyre, niveli më i ulët historik. Ndikim në uljen e praktikave të dëmeve pezull kanë patur inspektimet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me fokus dëmet dhe pagesat e tyre.

**Niveli i komisioneve të ndërmjetësimit në tregun e sigurimit të detyrueshëm motorik u reduktua ndjeshëm.** Hyrja në fuqi në janar 2022 e rregullores së miratuar nga Autoriteti solli ulje domethënëse të komisioneve të ndërmjetësimit në nivel tregu për sigurimet e detyrueshme motorike. Nga mesatarisht mbi 27%, këto komisione tashmë kanë arritur në nivelin prej 16%. Reduktimi i komisioneve të ndërmjetësimit dhe shpenzimeve të marrjes në sigurim ka rritur më tej likuiditetin e shoqërive të sigurimit për të realizuar në kohë pagesat e dëmeve.

**Byroja Shqiptare e Sigurimit (BSHS) doli nga monitorimi 10-vjeçar i Këshillit të Byrove.** Në vitin 2013, BSHS ishte vendosur në status monitorimi, për shkak të problematikave të mbartura me trajtimin e praktikave të dëmeve të Kartonit Jeshil dhe Fondit të Kompensimit. Përmirësimi i ndjeshëm i situatës, falë ndryshimeve të fundit ligjore dhe monitorimit të shtuar nga ana e Autoritetit, solli në dhjetor të vitit 2022 daljen e Byrosë Shqiptare të Sigurimit nga monitorimi i Këshillit të Byrove. Ndryshime të tjera ligjore që kanë pasur ndikim të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së BShS, janë edhe krijimi i Fondit të Garancisë për Kartonin Jeshil dhe për Fondin e Kompensimit, mbajtja e provigjoneve për dëmet pezull të Fondit të Kompensimit, riorganizimi i Byrosë, etj.

**Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për sigurimet TPL, ka patur një përmirësim të ndjeshëm të situatës me Fondin e Kompensimit.** Rezulton se për dëmet Fond Kompensimi, të ndodhura pas datës 1 korrik 2021, kur hyri në fuqi ligji i ri, asnjë çështje nuk është ankimuar në gjykatë. Gjithashtu, 87% e praktikave të dëmeve janë

paguar me procedura më të përshpejtuara përmes siguruesit të drejtpërdrejtë, një nga risitë e ligjit, ku i dëmtuari në një aksident të shkaktuar nga një mjet i pasiguruar ose i paidentifikuar mund ta kërkojë dëmshpërblimin direkt te shoqëria e tij e sigurimit.

Si një tjetër risi e ligjit, **Raporti Evropian i Aksidenteve** rezulton të jetë përdorur në rreth 23% të rasteve për dëmet TPL të trajtuara gjatë vitit 2022. Kjo praktikë mundësoi zgjidhjen me marrëveshje mes drejtuesve të mjeteve të përfshira në aksident, në rastet e dëmeve me vlerë deri në 30.000 lekë.

**Kapitali dhe aftësia paguese e shoqërive të sigurimit shënuan rritje të mëtejshme gjatë vitit 2022.** Kapitali (aftësia paguese) rezulton me rritje prej 14.2% krahasuar me vitin 2021. Në nivel tregu, treguesi i aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike (rezervat e dëmeve) për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës është rritur më tej në 133.5%.

Përgjithësisht, në vitin 2022 u shënuar një përmirësim i mëtejshëm i **treguesve financiarë kryesorë** që monitorohen nga Autoriteti. Tregu i sigurimeve e mbylli vitin 2022 me një rritje prej 9.2% të primeve të shkruara bruto, duke arritur në rreth 21 miliardë lekë të ardhura. Aktivitetet e tregut të sigurimeve u rritën me rreth 3 miliardë lekë, ose 7% më shumë se në vitin 2021. Rritje u shënuar edhe sa i përket nivelit të provigjoneve teknike me rreth 1.7 miliardë lekë, ose 8% më shumë sesa viti 2021. Përmirësim kanë shënuar edhe tregues të tjerë të shoqërive të sigurimit, si rezultati financiar, raporti dëme/prime, treguesi i mbulimit të provigjoneve teknike me aktive të përshtatshme për shoqëritë e sigurimit të Jo-Jetës, etj.

**Në tregun e sipërmarrjeve të investimeve kolektive,** gjatë vitit 2022, zhvillimet në tregjet ndërkombëtare, shoqëruar me rritjen e normave të interesit sollën ndikime në sjelljen e investitorëve, përmes një riorientimi të investimeve të tyre brenda sistemit financiar. Rritja e normave bazë të interesit ndikoi në vlerën e portofoleve të fondeve të investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, të cilat karakterizohen nga përqendrimi i lartë i investimeve në tituj borxhi të Qeverisë. Rënia e vlerës së titujve në portofolet e fondeve të investimeve me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, solli edhe rënien e çmimit të kuotave të këtyre fondeve, gjë që shkaktoi rritje të kërkesave për tërheqje nga investitorët, e për pasojë një rënie të vlerës së aseteve neto me mbi 40%. Në anën tjetër, nga monitorimi i të dhënave të

tregut me pakicë të titujve të Qeverisë u shënua një rritje me 216% e blerjeve të individëve në tregun primar, çka tregon lëvizjen e fondeve të investitorëve të tregut të sipërmarrjeve të investimeve kolektive brenda sistemit financiar.

Referuar fondeve të investimit, Autoriteti ka ndërhyrë me një sëri masash gjatë vitit 2022, si edhe po vijon monitorimin e kujdesshëm të situatës. Nga mbikëqyrja e deritanishme e këtij tregu, mbi bazën e raportimeve me frekuencë të shtuar, si dhe nga raportimi financiar i shoqërive administruese, ka rezultuar se treguesit e likuiditetit për të gjitha fondet e investimit me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike kanë qenë në përputhje me kërkesat e bazës rregullatore për likuiditetin. Në muajt e parë të vitit 2023, fondet e investimeve i janë rikthyer rritjes, megjithatë Autoriteti do të monitorojë në vijimësi ecurinë e këtij tregu.

Sa i përket zhvillimeve të tjera, **në tregun e kapitaleve**, në vitin 2022, në drejtim të zgjerimit të llojeve të shërbimeve të investimit, për herë të parë u licencuan dy subjekte (banka) për ofrimin e shërbimit të nënshkrimit të titujve (*underwriting*), u licencua një bankë për ofrimin e shërbimit të administrimit të portofoleve individuale, si dhe për shërbimin e këshillimit në investime, si edhe u autorizua një bankë për të ofruar shërbimin e shitjes online të bonove të thesarit, përmes një platforme digjitale. Gjithashtu, subjektet e tregut (bankat tregtare) zgjeruan licencën e tyre për të ofruar një gamë më të gjerë të instrumenteve financiare, përtej titujve të Qeverisë, duke i dhënë mundësi investitorëve për më shumë alternativa investimi.

Tregu i obligacioneve të emetuara me ofertë private shënoi rritje të mëtejshme gjatë vitit 2022. Shuma e pashlyer e këtij instrumenti financiar arriti në rreth 14 miliardë lekë, me një rritje prej rreth 40%, krahasuar me fundvitin 2021. Gjatë vitit të kaluar, Autoriteti regjistroi 11 akt-oferta për obligacionet me ofertë private, ku investitorët kryesorë janë individët.

**Tregu i fondeve të pensionit privat** ka vijuar tendencën e tij në rritje, si në vlerën e aktiveve neto, ashtu edhe në numrin e anëtarëve. Në krahasim me vitin 2021, aktivet neto të këtij tregu në fund të vitit 2022 arritën në 5.7 miliardë lekë, me rritje prej 24.3%, ndërsa numri i anëtarëve është 36,518 dhe ka shënuar një rritje me rreth 8.8%. Pritshmëritë janë që ligji i ri, i cili pritet të miratohet nga Kuvendi, t'i japë një shtysë të mëtejshme zhvillimit të këtij tregu.

Autoriteti ka forcuar bashkëpunimin me organizatat dhe institucionet financiare ndërkombëtare, si edhe autoritetet homologe rajonale dhe evropiane. AMF aderoi në Memorandumin Shumëpalësh të Mirëkuptimit, të Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), duke u bërë rregullatori i parë në rajonin e Ballkanit Perëndimor që bëhet pjesë e këtij Memorandumi. Kjo pjesëmarrje i shërben shkëmbimit të informacionit dhe mbikëqyrjes efektive të grupeve ndërkufitare të sigurimeve. Autoriteti gjatë vitit 2022 nënshkroi marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin e Shërbimeve Financiare të Maltës (MFSA) dhe Komisionin e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Luksemburgut (CSSF). Gjithashtu, AMF dakordësoi së fundmi nënshkrimin e Memoradumit të Mirëkuptimit me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë (FMA), duke zgjeruar fushat e bashkëpunimit, përtej tregut të sigurimeve, ku në vijimësi dy rregullatorët bashkëpunojnë, shkëmbejnë informacion, si edhe zhvillojnë inspektime të përbashkëta në kuadër të grupeve austriake të sigurimit.

Gjatë vitit 2022, Autoriteti organizoi dy konferenca ndërkombëtare, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Sekretariatit Zviceran për Cështje Ekonomike (SECO), mbi nevojën e diversifikimit të sistemit financiar përmes zhvillimit të tregjeve të kapitalit, si edhe zhvillimin e financave të gjelbra në Shqipëri, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe rritjes së njohurive financiare. Autoriteti, në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Arsimit dhe aktorë të tjerë janë koordinuar për ndërmarrjen e nismave të përbashkëta për rritjen e edukimit dhe përfshirjes financiare në tregjet nën mbikëqyrje. Autoriteti ka hartuar gjithashtu një dokument strategjik 5-vjeçar për edukimin financiar, mbështetur edhe në strategjinë e institucionit.

*Të nderuar anëtarë të Komisionit, më lejoni të ndaj me ju, në fund të fjalës time, disa nga drejtimet kryesore ku do të përqendrohet veprimtaria e Autoritetit gjatë vitit në vazhdim:*

Në mbështetje të Strategjisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare 2023-2027, gjatë vitit 2023 drejtimet kryesore të veprimtarisë së Autoritetit do të përqendrohen në objektivat e mëposhtme:

- Forcimi i stabilitetit financiar, rritja e efektivitetit të mbikëqyrjes dhe integritetit të tregjeve;
- Përafrimi i legjislacionit me standardet evropiane, zhvillimi dhe modernizimi i tregjeve;
- Mbrojtja e interesave të konsumatorit dhe investitorit;
- Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikat evropiane;
- Digjitalizimi dhe përmirësimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare do të vijojë të kontribuojë në nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e sigurt të tregjeve financiare nën mbikëqyrje, duke luajtur rol proaktiv në funksion të mirërregullimit dhe zhvillimit të këtyre tregjeve. Prioritet i Autoritetit do të jetë forcimi i mëtejshëm i funksionit të tij mbikëqyrës, duke zhvilluar dhe zbatuar mbikëqyrjen me bazë rreziku dhe përafrimi i mëtejshëm me standardet më të mira ndërkombëtare.

Përgjatë vitit në vijim, Autoriteti do vijojë me procesin e përafrimit të akteve ligjore dhe nënligjore me acquis të BE-së, duke marrë parasysh edhe rekomandimet e ekspertëve të Komisionit Evropian pas Takimeve Bilaterale të Brukselit.

Autoriteti, duke patur si objektiv themelor mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit, do të vijojë punën në drejtim të rritjes së kërkesave për transparencë dhe informacion, sipas standardeve ndërkombëtare. Veprimtaria e AMF-së do të përqendrohet në zbatimin e kërkesave të sjelljes së tregut, të cilat konsiderohen të rëndësishme për zhvillim afatgjatë dhe të qëndrueshëm, duke siguruar mbrojtje të konsumatorit dhe investitorit.

Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikat evropiane në financat e gjelbra vlerësohen thelbësore për një ekonomi dhe sistem financiar të qëndrueshëm. Autoriteti do të angazhohet që në bashkëpunim me institucione të tjera të ndërmarrë disa hapa konkretë në këtë drejtim, nisur edhe nga praktikat më të mira evropiane.

Së fundi, Autoriteti do të vijojë t'i kushtojë vëmendje të veçantë proceseve të digjitalizimit dhe mundësitë e përdorimit të teknologjive të reja, me qëllim përmirësimin e proceseve të mbikëqyrjes.



Zhvillimet e sistemeve të teknologjisë së informacionit do të shërbejnë për digjitalizimin e mëtejshëm të procedurave të raportimit, standardizimin dhe automatizimin e proceseve mbikëqyrëse, qasje në kohë reale në sistemet e subjekteve të mbikëqyrura, analizimin dhe menaxhimin e të dhënave të tregjeve nën mbikëqyrje në mënyrë efikase, si dhe për të ruajtur integritetin e tregut.

Faleminderit!